



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 54
Prishtinë, më datë 02 shkurt 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj. Kurse, munguan: Sadik Idriz dhe Mursel Halilji.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Blerim Vela – OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Rita Hajzeraj, zv.kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 26.01.2010;**
- 3. Miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/L-36,**
- 4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve,**
- 5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,**
- 6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale,**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 janar 2010

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26 janar 2010, pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/L-36

Gjylnaze Syla – Tha se në amendmanetin 5 formulimi në fund të fjalisë nuk është si duhet. Propozoj që ta korrigojmë këtë gabim si vijon: “...në qoftë se përcaktohen këto vende, sipas ligjit...”

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/L-36 - me propozimin për korrigjim të amendamentit 5.

4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave tjera dalluese dhe sinjaleve, në këtë përbërje:

Teuta Hadri – raportuese,

Sadik Idriz - anëtar,

Mursel Halilji – anëtarë.

5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, në këtë përbërje: Flora Brovina –raportuese

Gjylnaze Syla – anëtare dhe

Nurishahe Hulaj – anëtare.

6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale,

Gjylnaze Syla – Propozoj që për këtë Projektligj komisioni të angazhoi një ekspert ligjor, sepse është një projektligj problematik dhe shumë i paqartë. Eksperti ligjor duhet të jetë njohës i kësaj lëmie. Ne duhet të bëjmë kërkesë në Kryesinë e Kuvendit për angazhimin e këtij eksperti. Sa i përket angazhimit të farmacistëve, ne do të mbajmë një dëgjim publik dhe në atë dëgjim të ftuar do të ketë edhe farmacistë.

Teuta Hadri – Nuk e beson që në Kosovë ka ekspert ligjor të produkteve medicinale. Kushton shumë nëse angazhohet ekspert të jashtëm dhe nuk ishte e mendimit që mjetet e ndara për komision të shfrytëzohen për këtë çështje, sepse janë një shumë jo e madhe dhe nevojat e komisionit janë të mëdha.

Rita Hajzeraj – U dakordua me propozimin e deputetes Gjylnaze Syla, për angazhimin e një eksperti ligjor. Njëherësh propozoi që për të njëjtin projektligj të organizohet edhe një dëgjim publik

Qamile Morina – Propozoi që para se grupi punues të filloj me shqyrtimin e këtij projektligji, komisioni të mbledh informata. Sa i përket angazhimit të ekspertit ajo ka propozuar këtë para se ligji të kaloi leximin e parë. Pajtohet me këtë ide, por mendon që ky komision duhet të angazhoi dy ekspert- një të fushës profesionale farmaceutike dhe një ekspert ligjor i cili pastaj do të ndihmonte komisionin në amendamentimin e projektligjit.

Flora Brovina – U pajtua me mendimin që mjetet e ndara për komision të mos shfrytëzohen për angazhimin e ekspertit për këtë projektligj. Në na presin ligjet shumë të rëndësishme siç është Ligji i punës dhe Ligji për sigurime shëndetësore, për të cilat ligje ne duhet të punojmë në grup dhe me ekspert. Për këtë projektligj mund të angazhohet një ekspert vendor dhe për angazhimin e tij mund të na ndihmojnë ndonjë organizatë që mbështet kuvendin.

Rita Hajzeraj – Tha se do të marrim informata për mundësinë e angazhimit të një eksperti lidhur me këtë projektligj. Organizatat që mbështesin Kuvendin vazhdimisht na kanë premtuar për mbështetje për ekspert. Jam e mendimit që të angazhohet një ekspert farmaceutik. Do të kemi edhe dëgjimin publik ku padyshim se do të marrin pjesë ekspert të ndryshëm.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

*Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në këtë përbërje: Rita Hajzeraj – raportuese,
Bujar Bukoshi- anëtar,
Qamile Morina – anëtare.*

7. Të ndryshme

Rita Hajzeraj – Njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me njoftimin e sindikatës së pavarur të QKUK-së, për grevën dhe protestën një - ditore që do të mbahet me datë 03 shkurt 2010. Hap diskutimin.

Teuta Hadri – Në vazhdimisht po ballafaqohemi me grevat e punëtorëve shëndetësorë. Në duhet të marrim përgjegjësinë si komision. Duhet të përkrahim punëtorët shëndetësorë dhe të marrim një qëndrim. Kërkesat e tyre janë të arsyeshme dhe përderisa ka mundësi për rritje të pagave për profesorët, pse nuk ka mundësi edhe për punëtorët shëndetësorë.

Nurishahe Hulaj – Tha se duhet të përkrahim kërkesat e punëtorëve shëndetësorë. Qeveria në vitin e kaluar është deklaruar se do të ketë ngritje të pagave deri në 30% dhe mbi 30%. Në buxhetin që kemi shqyrtuar për vitin 2010 këto të holla nuk janë projektuar. Kjo çështje ka mbet në të hyrat vetanake. Deklarata ka qenë se prej 1 janarit 30%-shi do të hyjë në vijë të rregullt buxhetore, kjo nuk ka ndodhur. Në duhet t'i drejtohem qeverisë me një rekomandim që të realizohet ajo që është premtuar në vitin 2009 për punëtorët shëndetësorë.

Gjylnaze Syla – Ne si komision duhet të marrim informata se pse ekziston konflikti në mes të sindikatave. Ndoshta komisioni duhet t'i vizitoj grevistët si dhe u pajtua me mendimin për t'ju drejtuar qeverisë lidhur me kërkesat e sindikalistëve.

Bujar Bukoshi – Sindikatat janë duke bërë greva joserioze dhe po degradojnë vetën dhe të tjerët, por pa dashur të hyjë në këtë kërkesat janë korrekte dhe të qëndrueshme. Nuk mendon që nuk komisioni duhet të vizitoj grevistët, por duhet të marr një pozicionim të qartë.

Rita Hajzeraj – Propozoi që komisioni të nxjerr një rekomandim dhe të dal në një konferencë për shtyp lidhur me këtë çështje.

Teuta Hadri – Tha se komisioni duhet të analizoj kërkesat e sindikalistëve. Nuk kemi nevojë të mbajmë konferencë për shtyp. Ne duhet urgjentisht të ftojmë në takim ministrin e ministrisë së shëndetësisë, në mënyrë që të na shpjegoj se pse nuk mund të ngritën pagat e punëtorëve shëndetësorë, duke u nisur nga fakti që ka pas suficit buxhetor.

Flora Brovina – Tha se kërkesat e punëtorëve të QKUK-së janë kërkesa të kahershme të këtij komisioni. Domethënë kemi kërkuar Ligjin e Punës, kemi kërkuar Ligjin për Sigurime shëndetësore, dhe paga dinjitoze. Statusi është çështje tjetër dhe nuk na takon që ne të merremi me këtë. Ne duhet të thërrasim sindikatat dhe përfaqësuesit e qeverisë. Jam kundër asaj që të mbajmë konferencë pa organizuar takim paraprak me palët. Çështja e ligjeve nuk është çështje e një ditë apo një jave.

Qamile Morina – Sindikatat te ne janë të politizuara. Për paga dinjitoze po pajtohemi të gjithë, mirëpo miratimi i ligjeve është çështje tjetër. Ne e dimë që Ligji për sigurime shëndetësore nuk mund të miratohet pasi që ai ligj është shumë i keq dhe më mirë do të ishte që sindikalistët të kërkonin reforma – riorganizim të sistemit shëndetësorë. Sindikata paraprake për 10 vite nuk ka arrit të bëjë asgjë për punëtorët shëndetësorë. Dhe ka filluar një riorganizim i brendshëm për një sindikatë të pavarur. Mirëpo në atë riorganizim politika ndërhyjnë. Ne duhet të analizojmë kërkesat dhe të mos ngutemi të dalim në konferencë pa i analizuar ato.

Gjylnaze Syla – Propozoi që komisioni të organizoj një takim me përfaqësuesit e Qeverisë, ministrive përkatëse dhe me sindikalistët dhe pas atij takimi komisioni do të nxjerr një rekomandim dhe do të deklarohet në media.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Të organizohet një mbledhje e komisionit ku do të ftohen: zv.kryeministri, ministri z.Alush Gashi, ministri z. Nenad Rashiç dhe përfaqësuesit e sindikatave të punëtorëve shëndetësorë. Mbledhja do të mbahet të premten në ora 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zv. Kryetare e Komisionit

Rita Hajzeraj